



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:173590

Datë: 14.11.2022

Numri i dokumentit: 03643298

C.nr.1002/2021

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh.... R.... nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson E... A..., avokat nga K...., kundër të paditurës....., me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit jubilar dhe kompensimi për ushqim për ditët e pranisë në punë, me vlerë të kontestit 1,481.25 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 08.11.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APPROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Sh.... R.... nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguajë:

- në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, në vlerë të 50% të pagës bazë, shumën prej 133.25 euro (njëqind e tredhjetë e tre euro, e njëzet e pesë cent);

- në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve të pranisë në punë për 674 ditë pune nga muaji Prill i vitit 2017 e deri në muajin Shkurt të vitit 2020, shumën prej 1,348.00 euro (njëmijë e treqind e katërdhjetë e tetë euro);

Gjithsej në shumën e përgjithshme prej 1,481.25 euro (njëmijë e katërqind e tetëdhjetë e një euro e njëzet e pesë cent), me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

II. OBLIGOHET e paditura, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 134 euro (njëqind e tridhjetë e katër euro) në emër të shpenzimeve të përfaqësimit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 03.08.2021, ka paraqitur padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës....., me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit jubilar dhe kompensimi për ushqim për ditët e pranisë në punë, me vlerë të kontestit 1,481.25 euro. Në padi, paditësja ka theksuar se është në marrëdhënie pune te e paditura si punëtore tenike në Shkollën e Mesme

të Ulët “Selami Hallaçi” në Gjilan, duke theksuar se e njëjta ka përvojë të punës mbi 10 vite. Meqë paditësja ka kërkuar paraprakisht nga e paditura kompensimin e shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit, ndërsa e paditura ka heshtur ndaj kërkesës, i është drejtuar gjykatës që në bazë të nenit 35, paragrafi 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës të aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyrohet e paditura që t’ia paguaj shumën prej 133.25 euro (njëqind e tredhjetë e tre euro, e njëzet e pesë cent) në emër të përvojës së punës; shumën prej 11,348.00 euro (njëmijë e treqind e katërdhjetë e tetë euro) në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës, gjithsej në shumën e përgjithshme prej 1,481.25 euro (njëmijë e katërqind e tetëdhjetë e një euro e njëzet e pesë cent), me kamatë ligjore 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës aq sa dalin në fund të kontestit.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi të datës 08.09.2021, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore në këtë çështje juridike kontestimore, për të vendos lidhur me kërkesëpadinë, ngase e njëjta konsideron se kompetente për të vendosur sipas kësaj çështje është Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, e jo Gjykata Themelore në Gjilan, pasi që e njëjta konsideron se pavarësisht se a është përgjigjur apo jo në kërkesën e paditësit, DKA-ja, respektivisht e paditura, paditësi ka pasë mundësi që mbi bazën e përgjigjes së DKA-së dhe për shkak të heshtjes administrative në afat ligjor t’i drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamentit për Çështje Administrative. Tutje ka theksuar se paditësi kërkesëpadinë e tij e bazon në Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës (në vijim: KKAK), të datës 18.04.2017 të miratuar dhe nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë (në vijim: MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (në vijim: SBASHK), respektivisht në dispozitat e nenit 35, paragrafi 7 dhe 8 të kësaj kontrate, e sipas të paditurës kjo kontratë nuk prodhon efekt juridik dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj komunës së Gjilanit, si e paditur në këtë rast, sepse kjo kontratë nuk është në fuqi, pasi që Ligji nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, i datës 06.05.2014 nuk ka paraparë një të drejtë të tillë sipas padisë dhe kërkesëpadisë dhe se çdo marrëveshje që parasheh të drejta jashtë këtij ligji nuk prodhon kurrfarë efekti juridik. Si arsye tjetër ka cekur se Kontrata Kolektive në hyrje të saj bazohet në Ligjin e Punës, i cili nuk parasheh një të drejtë të tillë të beneficioneve, pasi neni 77 i këtij ligji potencon se pensioni i vjetërsisë dhe i parakohshëm rregullohen me ligj të veçantë. Më tej ka theksuar se sipas nenit 90, paragrafi 8 të Ligjit të Punës, për të qenë kontrata në fuqi ligjore duhet të jetë e regjistruar në MPMS, kurse në rastin konkret kjo kontratë nuk është e regjistruar në organin e lartëcekur dhe në fund ka shtuar se nuk janë shtjerrë mjetet juridike sipas procedurës administrative me qëllim që të inicohet procedura gjyqësore për realizimin e të drejtës së paditësit, e më decidivisht si në përgjigjen në padi. Po ashtu e njëjta është thirrë edhe në parashkrim të kërkesës ngase sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji Nr.04/L-077 neni 353, paragrafi 3 dhe neni 357, paragrafi 1 si dhe sipas Ligjit nr.03/L-212 të Punës, neni 87 kemi parashkrim të lëndës për arsye se tash më paditësja ka 15 vite përvojë të punës, ndërsa dihet se një e drejtë e tillë i ka takuar pasi paditësja i ka bërë 10 vite përvojë të punës, që do të thotë një kërkesë të tillë e ka bërë pas 9 viteve, e po ashtu edhe nga neni 90, paragrafi 4, ka parashkrim pasi në këtë paragraf thuhet se marrëveshja kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje, jo më shumë

se 3 vite, ndërsa kontrata kolektive ka qenë në fuqi deri më datë 18.04.2020, kurse padia është ushtruar më datë 03.08.2021. Gjykatës i ka propozuar që të refuzojë në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi të datës 08.09.2021, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (më tej: LPK) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se padia e paditësit është e themeltë, për arsye se:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës gjykata konstatoi se mes palëve ndergjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe e njëjta përvojë pune mbi 10 vjet dhe 674 ditë pune nga muaji Prill i vitit 2017 e deri në muajin Shkurt të vitit 2020, fakte këto të cilat i vërtetoi nga vërtetimet e lëshuara nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët “Selami Hallaçi” në Gjilan, për përvojën e punës me numër të protokollit 194/2021 të datës 11.06.2021 dhe për ditët e pranisë në punë me numër protokollit 77/2021 të datës 25.02.2020.

Me nenin 398 të LPK-së, përcaktohet se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, si dhe me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*.

Gjykata ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, se ka mbi 10 vite përvojë të punës, dhe se pagën mujore e ka realizuar në lartësi prej 267.25 euro, sipas vërtetimit të lëshuar nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët “.....” në Gjilan, me numër të protokollit 194/2021 të datës 11.06.2021.

Andaj, gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditësit dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, konkretisht nenin 35, paragrafi 7, i cili përcakton se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2euro (dy euro) për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit të kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*; si dhe paragrafi 8, pika 8.1, i cili përcakton se *“Punëtorët(anëtarë të SBASHKUT-ut), në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, ashtu që për 10 vite të përvojës së punës i kompensohet 50% të pagës bazë”*.

Me Ligjin e Punës nr.03-L/212 parashihet se sa i përket çështjeve të punëdhënësit me punëmarrësin ata të drejtat dhe detyrimet e tyre mund t'i rregullojnë edhe me Kontratë Kolektive dhe Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me Ligj të punës, pra të drejtat e punëmarrësit me Kontratën Kolektive mund të avancohen më lartë se të drejtat e parapara me Ligjin e Punës.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e të paditurës lidhur me kundërshtimin e kompetencës lëndore të kësaj gjykate, por gjykata konsideron se kjo çështje juridike është në kompetencë të Gjykatës Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, e jo në kompetencë të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, pasi që të drejtat dhe detyrimet dhe raportet në mes palëve ndërgjyqëse janë të rregulluara me Ligjin e Punës, e rrjedhimisht edhe me KKAK-në. Për më tepër sipas nenit 2, paragrafi 2 të Ligjit të Punës, në mënyrë shprehimore është cekur: “Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës”, e në rastin konkret ligjet e veçanta të cilat e rregullojnë këtë fushë nuk kanë paraparë ndonjë mënyrë tjetër të zgjidhjes së kontesteve për këtë kategori të të punësuarve, e rrjedhimisht për vendosjen e këtij kontesti në mes palëve ndërgjyqëse është e kompetencës lëndore kjo gjykatë. Për më tepër, gjykata gjatë gjithë procedurës sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën e vet lëndore dhe nga arsyet e cekura më lartë vlerëson se kjo gjykatë ka kompetencë lëndore për të vendosur për këtë çështje kontestimore.

Lidhur me pretendimin e të paditurës të parashtruar me përgjigjen në padi se KKAK nuk prodhon efekt juridik për të paditurën, nga arsyeja se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate dhe nuk ka buxhet për zbatimin e kësaj kontrate, duke përfshirë edhe kundërshtimet tjera të cekura në përgjigjen në padi, gjykata vlerëson se këto pretendime janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme, pasi që KKAK është lidhur në nivel vendi sipas dispozitave të nenit 90 Ligjit të Punës, çka nënkupton se meqë KKAK është e lidhur në nivel vendi, e njejta prodhon efekt juridik edhe ndaj komunës së Gjilanit, këtu të paditurës. Pos kësaj, edhe me nenin 2 paragrafi 1, pika 1.1 të KKAK-së, në mënyrë shprehimore është paraparë se: “Dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet e Arsimit Parauniversitar.....”, ndërsa me pikën 1.2 të po këtij neni, është cekur se: “Dispozitat e kësaj Kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in, etj)...”. Në interpretim të kësaj dispozite, gjykata vlerëson se e paditura ka përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga KKAK, pasi që me këtë dispozitë është cekur qartë se të punësuarit por edhe punëdhënësit janë të detyruar t'i zbatojnë dispozitat e kësaj kontrate, andaj edhe të njejtët janë përgjegjëse në përmbushjen e detyrimeve të cilat dalin nga KKAK.

Sa i përket pretendimit tjetër të të paditurës ku ka theksuar se në bazë të nenit 90, pika 8 të Ligjit të Punës, për të qenë kontrata në fuqi ligjore duhet të jetë e regjistruar në faqen e MPMS, e njejta nuk është regjistruar fare në faqen MPMS dhe si e tillë nuk duhet të prodhoj efekt juridik, për gjykatën edhe ky pretendim nuk është i bazuar, pasi që sipas vlerësimit të gjykatës nuk është relevante se a është regjistruar apo jo KKAK në faqen e MPMS, sepse referuar nenit

47 të kësaj kontrate, është paraparë se pas nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët, e njëjta regjistrohet dhe depozitohet në MASHT, e jo në ndonjë organ tjetër siç pretendon e paditura, kjo për faktin se kjo kontratë është sektoriale dhe jo e përgjithshme dhe e njëjta prodhon efekt juridik vetëm për të punësuarit dhe punëdhënësit në sektorin e arsimit (neni 2 i KKAK-së). Sido që të jëtë, akti i regjistrimit dhe depozitimi i kontratave, sikurse kjo në rastin konkret i KKAK-së ka qenë përgjegjësi e karakterit administrativ e organit publik kompetent që të njejtën ta regjistroj apo depozitoj, e për të cilat lëshime eventuale nuk mund të kenë konsekuenca të punësuarit, e në këtë rast nuk mund të pësoj paditësi.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e të paditurës ku është thirrë në parashkrim të kërkesës së paditësit, mirëpo, sipas gjykatës një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi padia në gjykatë është parashtruar me datë 21.06.2021, pra, pas hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, andaj nisur nga rrethana të tilla rezulton se paditësi nuk ka pasur bazë ligjore për parashtrimin e një kërkesë të tillë para kësaj date, pra, para datës 18.04.2017, çka do të thotë padia është parashtruar në afatin ligjor të paraparë me nenin 87 të Ligjit të Punës, pasi që sipas nenit 87 të këtij ligji, në mënyrë shprehimore është paraparë se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj nga këto arsye rezulton se padia e paditëses është parashtruar brenda afatit ligjor prej 3 viteve nga dita e paraqitjes së kërkesës dhe rrjedhimisht kërkesëpadia e paditëses nuk është përfshirë në parashkrim ashtu siç pretendon e paditura.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve/ Ligji nr. 04/L-077 datë 19.06.2012.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohet shpërblimit për përpilimin e padisë në shumën prej 104 euro (njëqind e katër euro) dhe taksës gjyqësore për padi në shumën prej 30 euro (tridhjetë euro), e në shumën e përgjithshme prej 134 euro (njëqind e tridhjetë e katër euro).

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjiilan –Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil
C.nr.1102/2021, më datë 08.11.2022

Gjyqtarja
Floriqe Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2021:173590
Datë: 14.11.2022
Numri i dokumentit: 03643298